



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 13, datë 13.07.2021

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË ME FUNKSION HOTELERI “GREEN COAST HOTEL”,
KATEGORIA 5 YJE, 2, 3, 4, 5, 6 KAT MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË,
NË FUNKSION TË “GREEN COAST RESORT”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, pika 1, ë Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Green Coast” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë me funksion hoteleri “Green Coast Hotel”, kategoria 5 yje, 2, 3, 4, 5, 6 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, në funksion të “Green Coast Resort”, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Green Coast” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILIMIT TË TERRITORIT

LEDIA FOTA

